

Vjenë, 14.11.2020

Të dashur prindër dhe persona me të drejtë kujdestarie (Erziehungsberechtigte)!

Zhvillimi i infeksioneve me Covid-19 e bëri përsëri të domosdoshme një lockdown të fortë në Austri. Me qëllim që sistemi shëndetësor të mund të funksionojë edhe më tej dhe të sigurohet shërbimi ndaj njerëzve nëpër spitale, duhet të japin kontributin e tyre shumë fusha të jetës shoqërore: shitoret duhet të mbyllen përsëri, shërbimet si një termin në floktore duhet të ndalohen, kontaktet në hapësirën publike dhe në ndërmarrjet duhet të mënjanohen nëpërmjet punës sa më shumë të jetë e mundur në shtëpi.

Edhe shkolla preket nga këto masa.

Duke filluar nga e dita e martë, 17 nëntor 2020, në shkollat fillore, të mesme, klasat e ulta të gjimnazeve dhe shkollat politeknike ofrohet vetëm një shërbim i kufizuar për ndihmë mësimore. Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, të cilët kanë mundësi të gëzojnë përkujdesje në shtëpi dhe nuk kanë nevojë për ndihmë të veçantë, duhet të qëndrojnë në shtëpi.

Por për të gjithë fëmijët, që kanë nevojë për mbështetje, do të ketë ndihmë mësimore në grupe të vogla. Edhe fëmijët, të cilët nuk kanë një vend të përshtatshëm për të mësuar në shtëpi, mund të shkojnë në shkollë dhe të bëjnë atje në stacionet mësimore detyrat që marrin në kuadrin e mësimin në shtëpi (Home-Schooling).

Shumë e rëndësishme është për mua që përkujdesja të funksionojë mirë sidomos për ata fëmijë e të rinj, të cilët kanë vështirësi në lëndë të veçanta ose që kanë nevojë për ndihmë speciale. Mësuesit do t'u kërkojnë atyre me këmbëngulje që të shkojnë në shkollë, me qëllim që të mos krijojnë prapambetje në mësim dhe të humbin kontaktin me pjesën tjetër të klasës.

Të hënën, më 7 dhjetor, fillon përsëri funksionimi normal i shkollës.

Ju mund të jepni një kontribut të rëndësishëm që lockdown-i të tregojë ndikimin e dëshiruar: ju lutemi, reduktoni edhe ju kontaktet private në këtë kohë dhe ju lutemi mbajini fëmijët tuaj sa më shumë që të mundeni edhe në kohën e lirë në shtëpi, pavarësisht se kjo nuk është e lehtë dhe paraqitet shumë e vështirë sidomos për të rinjtë.

## Schulbetrieb ab 17. November 2020, Elternbrief und Beiblatt. Albanisch

Në fletën bashkangjitur gjeni udhëzime dhe rekomandime, me qëllim që t'í kaloni mirë këto tri javë Home-Schooling. Sidomos një rekomandim është veçanërisht i rëndësishëm për mua: kur ju ose fëmija juaj nuk mund ta duroni më situatën, atëhere më mirë lëreni fëmijën tuaj më mirë që të shkojë përkohësisht përsëri në shkollë. Një ose dy ditë janë shpesh një lehtësim i madh.

Të gjitha informacionet e tjera për Home-Schooling dhe formalitetet e regjistrimit në ndihmën mësimore, respektivisht stacionet mësimore në shkollë, mund t'í merrni direkt nga shkolla.

Unë ju uroj juve dhe familjeve tuaja gjithë të mirat në këtë kohë të vështirë!

Juaji



Heinz Faßmann

Ministër Federal për Arsimin, Shkencën dhe Hulumtimin shkencor

Vjenë, 14.11.2020

## Informacione për prindërit dhe personat me të drejtë kujdestarie (Erziehungsberechtigte)!

### Komunikimi dhe mësimi digjital

#### Sqaroheni edhe njëherë me shkollën tuaj mënyrën e komunikimit dhe si do t'i merrni materialet mësimore

- Për të gjithë nxënësit dhe nxënëset që ndjekin shkollat publike është në dispozicion Portali Shkolla Digjitale ([www.pods.gv.at](http://www.pods.gv.at))
- Në portalin Distance Learning (<https://serviceportal.eeducation.at/>) gjenden edhe për ju QuickGuide video mbi përdorimin e platformave mësimore më të zakonshme, nëse doni të informoheni sesi funksionojnë platformat mësimore.

#### Orë konsultimi virtuale

- Nëqoftëse ekzistojnë kushtet, shfrytëzoheni mundësinë për të marrë pjesë në orët virtuale të konsultimit nëpërmjet vidoekonferencës.

#### Tekste shkollore elektronike

- Për të mësuar në shtëpi mund të përdorni tekste shkollore elektronike që gjenden në [www.digi4school.at](http://www.digi4school.at). Shkolla juaj mund t'i porosisë kodet e nevojshme për përdorim.

#### Materiale nga Eduthek dhe Edutube

- Përveç këtyre, në [www.eduthek.at](http://www.eduthek.at) janë edhe rreth 6.000 materiale me ushtrime dhe rreth 800 video mësimore në dispozicionin tuaj.

### Disa këshilla se si mund ta organizoni ditën gjatë mësimin në distancë

- Ngrihuni siç bëni gjithmonë në një ditë pune ose shkolle dhe zgjojini fëmijët tuaj si zakonisht. Ruani rutinën e përditshme (dushin, veshjen, mëngjesin etj.)
- Përpiquni të sajoni për fëmijët tuaj një vend pune të veçuar dhe të qetë, të cilin mund ta përdorin gjatë gjithë kohës. Nëse është e mundur hapësira për mësim të jetë e ndarë nga hapësira për lojë.
- Mundohuni të hartoni së bashku me fëmijët tuaj një plan ditor për qëndrimin në shtëpi. Për mësimin në shtëpi është tepër e rëndësishme që dita të jetë e strukturuar. Planifikoni edhe pushime midis orëve të mësimin.

## Ndihmë në situatat problematike

- Sigurohuni që fëmija juaj, por edhe ju të mund t'u përgjigjeni në çdo kohë mësuesve dhe ju lutemi ta kontaktoni vetë të parët çdo mësues, nëqoftëse fëmija juaj ndihet i stresuar ose nuk e kupton më përmbajtjen e mësimit.
- Në rast se mendoni që ju ose fëmija juaj ka nevojë për një mbështetje në përballimin e kësaj situatë shumë të vështirë, drejtohuni te zyra përkatëse këshillimore e psikologjisë shkollore (kontaktet shikojini te [www.schulpsychologie.at/kontakt](http://www.schulpsychologie.at/kontakt)) ose – në situata akute – edhe te linja telefonike “Rat auf Draht” (Këshillë nëpërmjet telefonit), të cilën mund ta kontaktoni gjatë gjithë ditës në numrin 147 nga çdo vend në Austri.
- Mundësi për një mbështetje mësimore personale të fëmijës suaj nëpërmjet „digitale Buddies” (Miqve digjitalë) gjenden këtu: <https://weiterlernen.at/digitale-buddies>

## Personat që mund të kontaktoni

Për pyetje rreth funksionimit të mësimit dhe koronës është në dispozicionin tuaj **në të gjithë Austrinë** linja telefonike “Corona-Hotline” e Ministrisë së Arsimit me numrin 0800 21 65 95 (nga e hëna deri të premten prej orës 8.00-16.00), si dhe Shërbimi për qytetarët i Ministrisë për Arsimin, Shkencën dhe Hulumtimin shkencor (Bürger/innenservice) me numrin 0800 20 56 76 (nga e hëna deri të premten prej orës 8.00-16.00).

Në landet e veçanta këshilla të mira merrni nëpërmjet linjave telefonike hotline të Seksioneve të Arsimit (Bildungsdirektion). Këto mund t'i gjeni këtu:

[www.bmbwf.gv.at/hotlines](http://www.bmbwf.gv.at/hotlines).